



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

VENDIM

Nr.23, datë 24/12/2024

PËR

MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN E LEJES ME NR.SERIE 000104, MIRATUAR NGA KBU MAT ME VENDIMIN NR.25, DATË 1.12.2023 PËR PËRDORIMIN E BURIMIT UJOR NËNTOKËSOR PËR QËLLIME TEKNOLOGJIKE NGA SUBJEKTI “DIZI” SH.P.K TE SUBJEKTIT “NBT OIL” SH.P.K

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Mat,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor për qëllime teknologjike me Nr.serie:000104, miratuar nga KBU Mat me Vendim Nr.25, datë 1.12.2023, nga subjekti “DIZI” sh.p.k me NIPT:L51413015E te subjekti “NBT OIL” me NIPT:L28411501T:
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e përcaktuar e pus-shpimit (KRGJSH)

- $X= 485327$; $Y= 4627678$; $Z= 78$ m;

- Prurja mesatare : $Q_{mes}= 2$ l/sek

- Sasia e ujit në përdorim : $Q= 0.3$ l/sek

- Qëllimi i përdorimit : teknologjik (Pikë-Karburanti)

- Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur : Në gropë septike

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBU MAT

GJERGJ PRENDI

